

2 **Dita Nderkombëtare e Gruas**
U shënuar me aksione gjithandej në
Zvicër dhe botë

3 **Intervistë me Giuliana Lamberti**
drejtuese e shoqatës «Prindër
të fortë – të rinj të fortë!»

4 **Qeveritë në Kosovë shkojnë e vijnë**
– diskriminimi i pensionistëve të
kthyer nga Zvicra vazhdon

Nr. 2 | mars 2018 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch



Pamje nga një aksion protestues kundër përkeqësimit të ligjit të punës

Editorial



Të dashur/a lexues/e

Zvicra është e pasur. Mirëpo kjo pasuri nuk është e ndarë drejt e mirë. Dallimi mes pagës më të lartë dhe asaj më të ultë në korporatat e mëdha zvicerane në vitin 2016 ishte 1:165. Drejtori i Bankës UBS Sergio Ermotti po në të njëjtin vit fitonte 13,2 milion. Tani korporatat publikuan raportet e tyre vjetore. Ne gati se përditë do të dëgjojmë se si do të mund të rritet qarkullimi dhe fitimi. Tek këto korporatat origjina e ndarjes së pabarabartë e të ardhurave. Të marrim si shembull Nestlé. Në gjithë botën kjo korporatë ka arritur qarkullim prej gati 90 miliarda franga. 10 miliardë nga to Nestlé ua pagoi aksionarëve.

Për pagat e 323 000 të punësuarve Nestlé ka paguar të ardhura prej gjithsej 16 miliarda franga. Të punësuarit kanë punuar – aksionarët nuk e kanë lënë – siç e thonë bukur – parandë të punojë, por të punësuarit e Nestlé: Të punësuarit vitin e fundit punuan 32 javë për pagën e vet dhe 20 javë tjera për atë të aksionarëve. Tani përfaqësuesit e ekonomisë atakojnë edhe ligjin e punës. Ata flasin me dëshirë për «sfidat» e mëdha, për digjitalizimin.

Dhe kërkojnë që të punësuarit të jenë më fleksibël dhe të punojnë më gjatë, sikur edhe në shtëpi të jenë gjithmonë online dhe në gatis-hëri për punëdhënësin. Unia kundërshton këtë lloj imponimesh. Që angazhimi sindikalist ka ndikim, shihet tek pagat e ulëta, të cilat në vitet e fundit arritën të ngritën. Në shumë KKP ka paga, të cilat janë së paku 4000 franga.

Dhe në Kantonin Neuenburg dhe Jura vlejnjë pagat kantonale minimale prej përreth 20 frangave në orë. Kjo bënë Zvicrën pakëz më të drejtë. Pas kësaj fshihet një punë shumë e vështirë.

Marília Mendes und Roman Künzler

Beat Baumann

Iniciativa të dëmshme për shëndetin në Parlament Jo përkeqësimit të kushteve të punës!

Punëtorët e punëtorët kërcënohen nga përkeqësimi masiv i kushteve të punës. Në shumë sektorë, sikur bie fjala ai i transportit qysh tani mbretërojnë presioni i madh dhe stresi. Megjithatë Parlamenti është duke diskutuar disa initiative borgjeze mbi ligjin e punës, aprovimi i të cilave do të përkeqësonte më tej kushtet edhe ashtu të këqija të punës.

Aktualisht Parlamenti zviceran është duke shqyrtuar disa iniciativa borgjeze mbi ligjin e punës. Të djathtit duan që të zhveshin ligjin e punës, thuaja se të përjashtojnë evidentimin e orëve të punës dhe të çrregullojnë orarin e punës. Kështu ata sulmojnë edhe mbrojtjen e shëndetit të punëmarrësve dhe ndarjen e qartë mes kohës së punës dhe kohës së lirë.

Cilat janë kërcënimet për të punësuarit?

Nëse iniciativat e Karin Keller-Suter dhe Konrad Graber aprovohen, do të anashkalohej masat themelore mbrojtëse si orari maksimal i punës, pauzat dhe koha e çlodhjes, ndalesa për punë natën dhe të dielave. Kufiri mes kohës së punës dhe kohës së lirë do të zbehet dhe do të mbetet gjithmonë e më pak kohë e lirë dhe për të pushuar.

Harmonizimi i punës dhe familjes po bëhet gjithnjë e më i vështirë.

Njerëzit me obligime familjare e shohin veten të konfrontuar me shumë probleme, apo edhe ju duhet të heqin dorë nga vende të ndryshme të punës.

Sektori i logjistikës dhe transportit si laborator të përkeqësimit

Qysh tani kemi degë ekonomike, ku ligji i punës rrallë respektohet në mënyrë gjithëpërfshirëse. Nuk ka as edhe një ndërmarrje transportuese, e cila identifikon të gjitha orët e punës dhe që i paguan ato. Mungojnë kontrollat e qëndrueshme dhe Kontrata të mira Kolektive të Punës. Nevojiten sindikata të forta. Pikërisht edhe për shkak të nevojës së rritjes së pagave, të cilat ka vite janë duke çaluar edhe përkundër mbarëvajtjes së punëve në këtë degë ekonomike. Pasi, nga të gjitha degët ekonomike të Zvicrës, transporti dhe logjistika, shënojnë në përgjithësi ngritjen më të dobët të pagave.

Kjo mund të përmirësohet, vetëm nëse arrihet të zbrapset sulmi nga ana e platformës borgjeze si të tillë në marrëdhëniet normale të punës. Pasi, nëse dikush është i detyruar të punojë si i vetëpunësuar sipas modelit «Uber» (platformë kjo teknologjike e shërbimit-taksist), atëherë evidentimi i orëve të punës është përgjithësisht i pavlefshëm. Si ndërmarrje të transportit publik dhe transportin rrugor të mallrave, sektori i transportit dhe logjistikës paraqet një laborator për shfrytëzim të ri nën petkun e digjitalizimit.

Punëtorët dhe punëtorët kundërshtojnë

Nga shembulli i degës së logjistikës dhe transportit, shihet se si në Zvicër mbrojtja e kushteve elementare të punës edhe me digjitalizimin është bërë edhe më urgjente. Andaj punëmarrësit e sektorëve të ndryshëm kundërshtojnë planet e borgjezisë. Pas in-

dustrisë, e cila dorëzoi një peticion në vitin 2017, edhe të punësuarit nga shërbimet publike i kanë dorëzuar Parlamentit 1280 kartolina protestuese. Punëmarrësit kërkojnë, që refuzohen iniciativat e dëmshme shëndetësore. Punëmarrësit shprehin shqetësimin e tyre të madh për përpjekjet e vazhdueshme që, nën petkun e modernizimit, të dobësohet dhe të zhveshët tërësisht ligji i punës.

Mbrojtja e kushteve të punës

Përkeqësimi i ligjit të punës u nevojitet vetëm punëdhënësve. Parlamenti duhet të kujdeset për atë, që punëmarrësit në të gjitha degët ekonomike të kenë kushte njerëzore pune, pikërisht për shkak të digjitalizimit në rritje të punës. Kjo është në të mirë të punëmarrësve, familjeve të tyre dhe të tërë shoqërisë.

News

Të punësuarit e sektorit të shërbimeve kundërshtojnë

Të punësuarit e sektorit të shërbimeve tërheqin vërejtjen për përqendrimin e ligjit të punës. Bashkë me Unia rreth 1300 punëmarrës kërkuan nga Parlamenti që të angazohen për mbrojtjen e punëmarrësve dhe kundërshtojnë erozionin e ligjit të punës. Nëse kjo aprovohet, atëherë do të përqendrohen edhe më tej kushtet e punës qysh tani të këqija. Andaj me 5.3.2018 një delegacion i punëmarrësve nga sektori i shërbimeve i ka dorëzuar Parlamentit 1280 kartolina proteste.



Mbrojtje e njëjtë për kujdestaret në amvisnit private!

Propozimi i qeverisë federale për Kontratën Normale të Punës mbi 24 orë përkujdesje është absolutisht i pamjaftueshëm. Punëmarrësit e këtij sektori duhet ti nënshtrohen ligjit të punës. Përkujdesja 24 orësh sipas rregullit bëhet nga gratë. Nëse atyre u mohohen kushte korrekte dhe qëndrueshme të punës, atëherë kjo paraqet diskriminim në bazë të gjinisë. Pos kësaj këto gra janë në shumicën e rasteve janë migrantë. Një mbrojtje, e cila bazohet në Kontratën Normale kantonale të Punës, nuk është në pajtim me obligimet ndërkombëtare të Zvicrës (ILO/ONP konventa 189 mbi punën me dinjitet njerëzor për të punësuarit në amvisni).



Arka e të papunëve të Unia u ofron të siguruarve shërbim me SMS.

Arka e sigurimit të papunësisë (ALK/CC) e sindikatës Unia zbaton si arka e parë nacionale e papunësisë shërbim njoftimi përmes SMS-ve falas për të siguruarit. Të siguruarit informohen menjëherë dhe pa zvarritje, kur u dërgohen paratë e kompensimit. Kjo vlen edhe për dërgesat që përbëjnë shumën të vogla parash, si fala bie kompensimi për ndjeke kursesh, apo kur përllogaritet vetëm një pjesë e kompensimit ditor. Kështu të siguruarit gjithmonë kanë një pasqyrë të pagesave të hyra dhe dinë saktësisht se nga kur ata kanë në dispozicion paratë e arkës së papunësisë.



«Kush kujdeset, për ata që kujdesen?»

Dita e Olten-it (manifestim ky tradicional i Unia) u preokupua me temën e përkujdesjes. Rreth 100 persona të besuar sindikalist, anëtar/e aktiv/e dhe sekretar/e diskutuan aspektet e politikave sindikaliste të punës së kujdesit mes përgjegjësive individuale dhe kolektive. Disa nga aktivistët sindikal të Unia-s lanë përshtypje me prezantimet e luftës së suksesshme sindikaliste në ndërmarrjet që kanë të bëjnë me përkujdesjen, si fjala në shtëpinë e pleqve Nathalie-Stiftung, apo në atë «Notra Dame» të Gjenevës, si dhe për gjendjen e debateve politike mbi temën.

8 marsi: dita ndërkombëtare e gruas Mjaftë më! Aksionet në ditën e gruas

Dita ndërkombëtare gruas 2018 kësaj radhe u zhvillua në shenjë të barazisë në paga. Në gjithë Zvicrën me mijëra gra protestuan kundër zhvlerësimit të të drejtave të tyre kushtetuese. Në kantonin Jura, sindikata Unia dorëzoi një iniciativë kantonale për barazinë në paga.

Në Bernë mbi 1000 gra e burra që u solidarizuan kërkuan zëshëm zbatimin e barazisë në paga. Masazhi i tyre është e pamundur të keqkuptohet: «Mjaftë më! Ne kemi humbur durimin dhe nuk do të presim gjatë!» Demonstrata tjera për 8 mars i zhvilluan ndër të tjera edhe në Belinzona, Gjenevë dhe Arau.

Të zbatohet mandati kushtetues

Corinne Schärer nga drejtorja e Unia-s theksoi në Bernë: «Barazia në paga është mandat kushtetues, e jo dhuratë për gratë! Është paturpësi që gratë edhe më tej u shtyhen dekadat. Ne nuk do të presim edhe 60 vite, sikur me rastin e pushimit të lehonisë!»

Puna e grave ka më shumë vlerë

Puna e grave jo vetëm se paguhet më keq, porse shpesh edhe nuk pranohet mjaftueshëm. Andaj gratë e Unia-s zhvilluan aksione sindikaliste edhe nëpër ndërmarrje. Ato shpërndanë çokolata dhe komunikuan një mesazh të qartë: «Gratë meritojnë më shumë se sa një kockë sheqeri: pranimi i plotë i vlerës të punës së tyre!»

U dorëzua iniciativa kantonale

Në Delémont sindikata Unia dorëzoi iniciativën e saj kantonale për barazi në paga. Kjo kërkon nga parlamenti kantonale i Jura-s ndërmarrjen e masave konkrete, për të zbatuar barazinë në paga në nivelin kantonale. Tema është shumë e rëndësishme, iniciativën e nënshkruan përafërsisht 4000 persona.

Barazi në paga. Pikë. Fund!

Ka 37 vite në kushtetutën e vendit, ka 22 vite nga ligji i barazisë – dhe edhe më tej nuk zbatohet. Në vend se të korrigojë shkëlqimin e kushtetues, politikanët/et borgjez dhe punëdhënësit shkelin të drejtat e grave me të dyja këmbët: Parlamenti ndjek taktikë stërzgjatje; punëdhënësit kun-

dërshtojnë të kontrollojnë pagat. Sindikata Unia kërkon nga Parlamenti rregulla obliguese, për të mundësuar kontrollin e rregullt të pagave në të gjitha ndërmarrjet, si dhe të caktojë gjoha më të larta për ndërmarrjet e munguara.

Dita ndërkombëtare e gruas është shënuar në gjithë botën nga organizatat e grave edhe me 8 mars 2018. Kjo ditë njihet edhe si dita botërore e gruas, dita e gruas, dita e kombeve të bashkuara për të drejtat e grave, apo edhe si International Women's Day. Si e tillë u krijua në kohën rreth luftës së parë botërore me rastin e luftës për barazi gjinore dhe për të drejtën e votimit për gratë, dhe pas veti ka edhe një traditë të gjatë. Socialistja gjermane Carla Zetkin, me 27 gusht 1910, në Kopenhagë, i propozoi Konferencës së dytë të grave të Internacionales Socialiste, kundër dëshirës së kolegëve të saj partiak meshkuj, shpalljen e ditës ndërkombëtare të grave, pa favorizuar ndonjë datë të caktuar. Ideja për këtë propozim erdhi nga SHBA-të. Atje gratë e Partisë Socialiste të Amerikës (SPA) më 1908 themeluan komitetin e grave, ku u vendos të iniciohet një ditë e caktuar lufte për të drejtën e votimit të grave. Dita e parë e gruas u festua më pas, me 19 mars 1911 në Danimarkë, Gjermani, Austro-Hungari dhe në Zvicër. Që nga viti 1921 dita ndërkombëtare e gruas mbahet me 8 mars

Teksti «Dita ndërkombëtare e gruas» është marrë nga www.kleiner-kalender.de



Demonstrata në Bernë me rastin e 8 marsit 2018

Sektori i floktarisë KKP e re për sektorin e floktarisë

Unia, Syna dhe CoiffureSUISSE janë të kënaqura që qeveria federale ka deklaruar si obligues Kontratën e re Kolektive të Punës për sektorin e floktarisë. Kontrata me veti bie përmirësime të dukshme sa i përket pagë dhe vetëpunësimi fals.

Kontrata e re Kolektive për floktarinë zvicerane (KKP) hynë në fuqi më 1.3.2018 dhe duhet së e tillë detyrimit të zbatohet. Sindikatat Unia e Syna si dhe shoqata Coiffure SUISSE janë të kënaqura me këtë vendim, nga i cili përfitojnë 4279 floktari, e 10900 të punësuar.

Përmirësime pagash

Marrëveshja e pajtuar e partnerëve social në vitin 2017 parasheh posaçërisht futjen e sistemit të pagave, nga i cili përfitojnë ata që kanë përvojë profesionale. Nga viti i 5-të i përvojës në punë pas arsimimit për të punësuarit me certifikatë shtetërore të aftësisë

paga minimale është 4000 franga, me EBA (me diplomë profesionale federale) së paku 3900 franga: KKP parasheh për njerëz të këtij profesioni pa aftësim profesional një pagë minimale, e cila nga viti i 5-të i përvojës në punë dhe pas aftësimi sillet rreth 3800 frangash, si deh një shtesë page prej 200 frangash për punonjësit, të cilët aftësojnë shërgertët.

Përparime tjera

Për partnerët social KKP-ja për floktari është pa dyshim një përparim. Kontrata përbën edhe përmirësime të kushteve të punës për gratë dhe familjet. Partnerët social janë pajtuar edhe për luftimin e vetëpunësimi fals dhe pseudo praktikantëve. Ata gjithashtu kanë ndërmarr hapa për të shtuar aktivitetin kontrollues veçanërisht në Tiçino. Tani shpresojmë të gjithë që përmes kësaj KKP-je të ndikojmë më shumë kundër dumpingut në paga.



Me KKP profesioni i floktarisë do të trajtohet më mirë

Zgjedhjet federale të 3.3.2018

Votë e qartë për shërbimin publik dhe reliefin e shumëllojshëm në media!

Me 3 mars shumica e popullatës së Zvicrës u deklarua kundër iniciativës No-Bilag dhe për funksionimin e mëtejshëm të SRG (televizionit shtetëror zviceran), si dhe të radio e televizioneve tjera të shumta lokale e regjionale. Kështu qytetarët/ët e vendit treguan se qëndrojnë pas mediave të shumëllojshme, kualitative, me drejtpërdrejt dhe të pavarura. Kjo është vendimtare për unitetin kombëtar, për bashkëjetesën dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë gjuhësore e kulturore.

Rezultati i votimit të fundit tregon se çfarë vlerësimi i bënë popullata e vendit mbrojtjes dhe respektimit të minoriteteve gjuhësore të Zvicrës. Zhbërja e tarifave të koncesionit do të kishte si pasojë fundin e radio televizioneve numerike në gjuhën franceze, retoromane e italiane. Të gjitha këto kanë qenë të varura nga të ardhurat në Billag

Sindikatat janë të kënaqura mbi rezultatin!

Sindikatat janë lehtësuar dhe të lumtura, që është refuzuar qartas iniciativa shkatërrimtare «No-Bilag» të mbi 70% e jo-votave. Kështu janë shpëtuar edhe me mijëra vende pune dhe ekzistenca e mijëra të punësuarve. SRG (televizioni publik) dhe transmetuesit privat të financuar nga paraja publike përmes këtij votimi kanë një mandat të qartë: ata duhet të ofrojnë më shumë shërbime publike dhe në të ardhmen të dallohen me qartë nga transmetuesit komercial. Gjithashtu këta duhet të ofrojnë kushte pune, të cilat mundësojnë gazetari të mirë.

Rinovimi i regjimit financiar të federatës

Si pranim i qartë i shërbimeve publike është për tu vlerësuar edhe Po-ja për rregullat financiare. Popullata dëshiron që federata të ofrojë një shërbim të mirë publik dhe është e gatshme që për këtë edhe të paguaj. Kjo tregon gjithashtu se do të ishte koha që tatimi e drejtpërdrejtë federal të ankorohet si definitive në kushtetutën federale. Kështu federata mund të zbatojë mandatet publike edhe më tej.

Osman Osmani



Pamje e hartës së vendndodhjes së transmetuesve publik të Zvicrës

Personat e pa legalizuar: Sans-Papiers

Unia dënon sulmin borgjez kundrejt Sans-Papiers

Komisioni për siguri sociale i parlamentit zviceran përmes një mocioni dëshiron të bëjë më të rreptë diskriminimin e personave Sans-Papiers. Unia e dënon këtë sulm të panevojshëm karshi personave Sans-Papiers dhe kërkon nga parlamenti të refuzojë këtë kërkesë.

Komisioni parlamentar zviceran për siguri sociale ka aprovuar një mocion me 17 për dhe 8 kundër, i cili do të diskriminonjë edhe më shumë personat Sans-Papiers. Më pas ata duhet të përjashtohen tërësisht nga sigurimet sociale. Punëdhënësit dhe qiradhënësit duhet të dënohen më rreptë, nëse punësojnë apo u japin banesë personave Sans-Papiers. Pos kësaj fëmijët e personave të pa legalizuar që janë duke ndjekur shkollimin e rregullt obligues, duhet tu raportohen enteve shtetërore, për ti sanksionuar ato.

Diskriminimi nuk bie asnjëfarë zgjidhje

Rreptësia diskriminuese, e cila personat pa letra i shtynë në buzë të greminës, nuk kontribuon në asnjë mënyrë në

zgjidhjen e situatës së personave Sans-Papiers. Kjo qon më shumë drejt përshkallëzimit, pa u ofruar njerëzve një perspektive me dinjitet.

Gjeneva tregon një rrugën më të mirë

Përpyqjet pozitive integruese sikur projekti «Papyrus» i kantonit të Gjenevës tregon qartas drejtimin që duhet ndjekur. Integrimi i personave Sans-Papiers për të mirë e të gjithëve është i mundur në kuadër të kornizave ligjore dhe urgjentisht i nevojshëm. Unia kërkon nga parlamenti që ketë mocion diskriminues e kundër produktiv ta hedhë poshtë në seancën parlamentare të verës.


Zoltan Doka



Pamje aksioni protestues për legalizim të personave pa letra në Zvicër

Intervistë

Giuliana Lamberti



Kush qëndron pas shoqatës S.E.S.J. «Prindër të fortë – rini e fortë»?

Shoqata S.E.S.J. është themeluar në tetor 2015. Ud-hëheqëse e projektit është Giuliana Lamberti. Anëtarë të kryesisë janë Osman Osmani dhe Marilia Mendes që punojnë në Unia dhe Alex Wick, pronar i ndërmarrjeve të ndryshme të vogla dhe të mesme.

Kujt i dedikohen ofertat e shoqatës?

Shërbimi ynë u drejtohet në rënd të parë prindërve e të rinjve me shkollës dhe profesionit. Këtu përfshihen edhe personat kujdestar apo përgjegjës e të rinjve, si deh vet të rinjtë. Pos kësaj këshillimores mund ti drejtohen edhe shoqatat e migrantëve, këshillimoret tjera, shkollat dhe ndërmarrjet.

Cila është oferta e shoqatës?

Oferta jonë përfshinë këshillimin personal dhe telefonik, informimin dhe manifestimet. Prindërit mësojnë se si mund të shoqërojnë e mbështesin suksesshëm fëmijët e tyre në fazat e rëndësishme dhe janë të informuar me shërbimet e ofertat ekzistuese për të rinjtë në rrafshin e punës, arsimimit dhe qendrave profesionale gjegjëse.

Ne këshillojmë dhe shoqërojmë prindërit, në rast se fëmija i tyre nuk ka gjetur vend për mësim të zejes e arsim profesional, shkollim të mëtejshëm apo ndonjë zgjidhje tjetër. Ne informojmë se ku mund të gjejnë ndihmë në rast vështirësisë dhe se ku mund të drejtohen në rast të pyetjeve e preokupimeve tjera. Falë një rrjetëzimi të gjerë dhe të mirë, ne mund të tregojmë mundësitë e zgjidhjeve të përkohshme apo kalimtare. Shërbimet janë pa pagesë dhe mund të ofrohen në gjuhë të ndryshme.

Cili është qëllimi i shoqatës?

Qëllimi i shoqatës S.E.S.J. është që të mbështeten prindërit e të rinjtë mes shkollës dhe profesionit dhe ata të informohen mbi ofertat për të rinjtë, në mënyrë që fëmijët e tyre para dhe gjatë arsimimit profesional të mund të shoqërohen sa më mirë që është e mundur. Kështu duhet të rriten gjasat për fillim dhe ngritje profesionale të fëmijëve. Prindërit duhet të fuqizohen në rolin e tyre dhe që ata të kyçen më shumë e më fortë në vendimet kryesore përreth shkollimit dhe arsimimit profesional.

Sipas një studimi të rinjtë migrantë në veti bartin rezerve të mëdha dhuntish. Ata që përfundojnë më suksesin më të mirë arsimim profesional në Zvicër janë pikërisht migrantët. Ata jo vetëm që nuk mbeten pas profesionistëve më të mirë të Zvicrës, por shënojnë dhe ngritje të suksesshme edhe në karrierën profesionale, nëse marrin mbështetje të suksesshme nga familja.

Si doni të arrini realizimin e qëllimeve tuaja?

Duke arritur dhe mbështetur sa më shumë prindër që është e mundur. Për këtë arsye ne duam që shërbimin dhe ofertën tonë ta bëjmë sa më publike, që prindërit të mund të mësojnë dhe përfitojnë nga shërbimet tona pa pagesë. Është me rëndësi që mediat për këtë të raportojnë dhe që politika të fuqizojë prindërit. Mirëpo edhe organizatat sikur Unia duhet të bashkëpunojnë me organizatat tjera dhe që anëtarët e tyre, që shpesh janë edhe prindër, ti njoftoj për këtë mundësi mbështetjeje.

Si financohet shoqata dhe aktivitetet e saja?

Shoqata aktualisht financohet nga tri fondacione private dhe nga departamenti për çështjes sociale i qytetit të Cyrihut.

Çka duhet bërë për të përfutur nga aktivitetet tuaja?

Për tu këshilluar mjafton një thirrje. Ne shumë shpejtë caktojmë terminin. Këshillimet janë pa pagesë. Nëse prindërit nuk njohin gjermanishten, ne organizojmë edhe përkthimin. Ne jemi të gatshëm me dëshirë që bashkë me shoqata të migrantëve dhe organizata tjera të organizojmë manifestime mbi temën sistemi shkollor dhe profesional i Zvicrës dhe se si prindërit mund ti mbështesin fëmijët e tyre në fazën kalimtare mes shollës dhe profesionit.

A doni të shtoni edhe diçka?

Më 2012 Komisioni i migracionit në Unia pat trajtuar temën se si prindërit mund të mbështesin fëmijët e tyre për një perspektivë më të mirë jetësore. Osman Osmani, Marilia Mendes dhe Giuliana Lamberti kanë punuar më tej në këtë temë dhe në vitin 2015 kanë themeluar shoqatën S.E.S.J. Ne jemi një shoqatë private dhe të obliguat të respektojmë fshehtësinë personale. Të gjitha bisedat trajtohen me besueshmëri. www.sesj.ch, Tel. 044 242 27 27

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Puna të dielave: A marrë shtesë page?

Një herë në muaj unë punoj edhe të dielave. Për punën të dielave unë nuk marrë shtesë page. Një i njohur, i cili punon normalisht nga e hëna deri të premten, ka punuar përjashtimisht në dhjetor në dy herë të diela. Për këtë ai ka marrë një shtesë page prej 50%. Andaj ia kam shtruar pyetjen vetit, se nuk duhet edhe unë ti kërkojë shefit tim, që për punën të dielave të marr pagë më të madhe.

Mirjam Brunner: Mjerisht jo. Ligji bënë dallimin mes «punës së përkohshme të dielave» dhe «punës afatgjate dhe të rregullt e të përsëritur të dielave». Vetëm për «punën e përkohshme të dielave» është paraparë një shtesë page prej 50%. Kjo në rastin e punës sporadike në jo më shumë se gjashtë të dielave në vit. Mirëpo ju keni punuar më shumë se gjashtë të diela në vit, andaj për ju vlen rregulli për «punës afatgjate dhe të rregullt e të përsëritur të dielave». Kjo nuk parasheh shtesë page. Nëse në Kontratën e juaj Individuale apo atë Kolektive të Punës nuk është shënuar ndryshe, atëherë nuk ka shtesë page. Vetëkuptohet se keni të drejtë në një ditë zëvendësuese pushimi, derisa punoni të dielave.

Work, 2 shkurt 20178

Koha e pushimit: A mjaftojnë 9 orë në shtëpi?

Dje mua më është dashur të punoi deri në ora 20. Pasi rruga për në punë më zgjat një orë, në shtëpi kam arritur në ora 21. Sot më është dashur të largohem nga shtëpia në ora 6 për të arritur t'ia filluar shërbimin tim të ardhshëm në ora 7. A mund të kërkoj shefi im, që unë përsëri kaq herët të jem në vendin tim të punës, nëse unë në mbrëmje aq vonë kam arritur në shtëpi?

Mirjam Brunner: Po. Në rastin tuaj është respektuar koha e paraparë e pushimit. Mes dy ditëve të punës duhet në fakt që të keni 11 orë të njëpasnjëshme të lira. Një herë në javë koha e pushimit bile mund të zbritet në 8 orë, nëse koha mesatare e pushimit përgjatë dy javëve ka qenë së paku 11 orë. Se sa zgjat rruga nga ndërmarrja në shtëpi, nuk luan me këtë rast ndonjë rol. Nëse në ora 20 largoheni nga ndërmarrja, është legjitime që 11 orë më pas të jeni përsëri në gatishmëri pune. Koha e pushimit ditor i shërben të ushqyerit dhe çlodhjes. Rregulli i paraparë ligjor prej 11 orësh kohë pushimi, andaj është shumë më i shkurtër. Nëse koha e pushimit përjashtimisht zbritet në 8 orë, kjo kohë mes orarit të punës nuk mjafton për tu ushqyer dhe për të fjetur. Për këtë arsye, është i lejuar ky maksimum prej një herë në javë. Tek 11, gjegjësisht 8 orë kemi të bëjmë me kohën minimale të pushimit, e cila në asnjë rast nuk guxon të tejkalohet. Më rëndësi është me këtë rast, që këto orë ti keni përnjëherë pushim. Vetëm kështu është i mundshëm pushimi i drejtë.

Work, 2 shkurt 2018



Marrëveshja ndërshtetërore për Sigurimet Shoqërore mes Zvicrës e Kosovës Angazhimi sindikalist dhe lobimi politik lëvizin gjërat shoqërore

Me 2 shkurt 2018 një delegacion tre anëtarësh i përbërë nga dy profesionistë të sindikatës Unia bashkë me deputeten dhe anëtarin e komisionit për politika sociale të Parlamentit të Zvicrës, ishin të ftuar në mbledhjen e radhës nga kryetarja e Komisionit parlamentar të Republikës së Kosovës për Shëndetësi, Punë e Mirëqenie Sociale, zonja Besa Baftiu. Në këtë mbledhje morri pjesë edhe Ministri përgjegjës z. Skender Reçica me ekipin e tij.

Maratona e padrejtësisë dhe diskriminimit ekskluziv për shtetasit Kosovës që ka filluar me 1 prill 2010 vazhdon deri sa të hyjë në fuqi marrëveshja e arritur teknike e administrative më 1 qershor 2017. Qeveritë e dy shteteve Zvicra e Kosova ka tetë (8) vite që vazhdojnë të injorojnë gjendjen e rëndë të shtetasve të Kosovës – përfutjesve të pensioneve nga Sigurimet Shoqërore të Zvicrës bazuar në Marrëveshjen ndërshtetërore.

Në vijim sa për informim të lexuesve tanë dhe të prekurve, po japim vetëm përmbledhjen e fjalët të pjesëtarëve të delegacionit në mbledhjen e komisionit të 2 shkurtit 2018:



Ruzhdi Ibrahim, Barbara Gysi, Osman Osmani

Fjala e deputetes së Parlamentit të Zvicrës

Deputetja e Parlamentit zviceran Barbara Gysi, theksoi se ajo nuk mund të flas zyrtarisht për shtetin e Zvicrës, por e din se arritja e marrëveshjes është stërzgatur dhe vendimet politike janë çështje e niveleve ministrore. Sipas informatave që ajo posedon, kjo mund të zgjasë edhe disa javë apo muaj. E rëndësishme është që të arrihet nënshkrimi i marrëveshjes nga të dy qeveritë, e pastaj të ndërmerren hapat e mëtutjeshëm për ratifikim të saj. Ajo njoftoi edhe për grupin e themeluar të miqësisë të parlamentarëve të Zvicrës dhe të Kosovës, që shpreson se do të ndihmojnë në ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Ajo u pajtua që ndërprerja e kësaj marrëveshjeje ka qenë shkelje e të drejtave të njeriut dhe se kjo ndër të tjera ka qenë edhe arsye pse ajo dhe miqtë tjerë deputetë janë angazhuar shumë në këtë çështje. Sa i përket pyetjes për periudhën e kaluar, se a mund të gëzohen të drejtat për këtë periudhë të humbur, ajo premtoi se do të angazhohet që edhe kjo çështje të trajtohet... sido që të jetë, e rëndësishme është që marrëveshja të arrihet sa më shpejt që të jetë e mundur, ka përfunduar ajo.

Fjala e ekspertit të Sigurimeve Shoqërore të Zvicrës

Eksperti i diplomuar në Zvicër për sigurimet shoqërore, Ruzhdi Ibrahim ndër të tjera theksoi se: janë mbushur tetë muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes teknike në mes dy grupeve negociuese dhe opinioni nuk është i informuar se çfarë është ndërmarrë nga dy qeveritë për arritjen e

marrëveshjes në fjalë; se kemi shumë njerëz, që tani tetë vite, nuk kanë arritur t'i realizojnë përfitimet në pensione të pleqërisë, pensione të invaliditetit, pensionet e vejërisë dhe pensionet e fëmijëve; se shumë nga këta përfitues, që kanë pasur të drejta, edhe kanë vdekur dhe se procedura e verifikimit të arritjes së marrëveshjes nga dy qeveritë është e domosdoshme. Më tej ai shtoi se është e domosdoshme për t'u cekur pjesa e informimit, e cila nga pala kosovare nuk është arritur sa duhet, njerëzit e prekur nuk e kanë informacionin e duhur sesi duhet të veprojnë gjatë kësaj periudhe. Përfitimet nuk mund t'i gëzojnë pa hyrë në fuqi marrëveshja. Është e rëndësishme që të trajtohen disa çështje përmbajtjesore, siç është çështja e periudhës tetë vjeçare, që të gjithë individët që kanë qenë të sigurar në Zvicër për këto vite nuk kanë të drejtë në përfitime.

Fjala e të ngarkuar me dosjen e Marrëveshjes në fjalë në sindikatën Unia

Sekretari nacional i Unia-s, Osman Osmani potencoi se ai me bashkëpunëtorë që nga viti 2010, janë takuar e kanë diskutuar me deputet e zyrtarë të të dyja vendeve që kjo çështje të ecën tutje. Ai shtoi se njëra nga detyrat e tij kryesore është edhe që të përkujdeset për të mbi 10 mijë anëtarët, të cilët janë shtetas të Republikës së Kosovës. Përveç mbrojtjes dhe sigurisë në punë, janë edhe sigurimet shoqërore, për të cilat ata përkujdesen që të mos ketë diskriminim dhe që marrëveshjet të zbatohen. Me tej ai tha se

deputetët e Kuvendit të Kosovës janë të informuar mjaftueshëm me këtë problematikë, por nuk janë të informuar fare vet të prekurit, të cilët nuk e dinë se si të veprojnë në këtë situatë dhe se ministria përkatëse e shtetit të tyre ishte dashur t'i informojë ata për hapat që këta duhet t'i ndër-marrin, apo jo. Ata, tani tetë vite janë zhvatur dhe keqpërdorur nga agjenci të ndryshme, theksoi ai. Sa i përket informimit të publikut, ai kërkoj që edhe tani të bëhet informimi i të prekurve, që ata të mos nguten për t'i tërhequr mjete e tyre, gjë që është një dështim i institucioneve të Kosovës, përderisa në Zvicër ndodh informimi i të prekurve dhe atë në gjuhën shqipe sikur edhe në të tri gjuhët zyrtare të Zvicrës.

Osman Osmani

Marrëveshja e re për Sigurimet Shoqërore me Kosovën Tetë vite diskriminim marrin fund

Në mbledhjen e sotme Qeveria Federale e Zvicrës aprovoi Marrëveshjen e re për Sigurimet Shoqërore me Kosovën. Më këtë vendim merr fund diskriminimi 8 vjeçar e shtetasve të Kosovës, të cilët në mënyrë të rregullt kanë paguar kontributet e tyre në sigurimet shoqërore të Zvicrës. Sindikata Unia kërkon nga qeveria federale të zbatojë masat e përshtatshme, për të baraspeshuar humbjet e shkaktuara për kohën e mungesës së zbatimit të Marrëveshjes.

Presioni i Unia tregoi ndikim – eksperimenti i së djethtës dështoi

Sindikata Unia u angazhua fuqishëm për ti dhënë fund këtij diskriminimi. Presioni që ushtroi Unia tregoi ndikim: me aprovimin e Marrëveshjes së ri negociuar, të gjithë të punësuarit nga Kosova në Zvicër janë të barazuar m të tjerët, pavarësisht se a marrin pensionin e tyre në Zvicër apo jashtë saj, pra edhe në vendin amë.

Kërkohej ratifikim i shpejtë

Me adoptimin e sotëm dhe nënshkrimin e planifikuar në qershor me qeverinë e Kosovës, qeveria federale hap rrugë të përparojë ratifikimin në Parlament. Unia kërkon nga Parlamenti që të përshpejtojë ratifikimin. Pasi vetëm kështu mund të përfundojë ky diskriminim i pa përbalueshëm.